



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVA

## Fjalimi përshëndetës i Guvernatorit

*Dhjetor 12, 2023*

---

**Konferenca:** Financimi i Bujqësisë dhe Sigurimet Bujqësore, Projektet e IFC-së në Kosovë

**Organizator:** MBPZHR dhe IFC

**Koha dhe vendi:** 12 dhjetor 2023 ora 09:30-13:30, Swiss Diamond Hotel, Prishtinë

---

E nderuara, znj. Çerkini, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

I nderuari, z. Perani, Udhëheqës i Zyrës së Korporatës Financiare Ndërkombëtare për Kosovë

I nderuari, z. Zaripov, Udhëheqës i projekteve nga IFC për Sigurimet Bujqësore në Kosovë

Të nderuar drejtues të institucioneve financiare,

Të nderuar ndërmarrës dhe bujq,

Shumë të respektuar të pranishëm,

Jam i nderuar të marr pjesë në këtë ngjarje sot, në përmbyllje të projektit të përbashkët ndërmjet Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC), anëtare e Bankës Botërore mbi Financimin e Bujqësisë dhe Sigurimet Bujqësore.

Siç dihet, sektori i bujqësisë në vendin tonë paraqet një mundësi jashtëzakonisht të madhe për t'u zhvilluar dhe për të kontribuar në zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendit edhe pse ky sektor karakterizohet me pasiguri të ndryshme natyrore dhe lëvizje të çmimeve të tregut, përtej punës së palodhshme të fermerëve tanë.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij sektori është e domosdoshme të forcohet angazhimi ynë përmes mekanizmave të ndryshëm si nga politikëbërja ashtu edhe nga perspektiva e mbështetjes financiare dhe siguruese në funksion të gjithëpërfshirjes financiare dhe qasjes në financa me kosto të përballueshme.

IFC përmes projekteve për të fuqizuar sektorin e bujqësisë sikurse janë sistemi i sigurimit të bujqësisë dhe qasja në financa për fermerët ka bashkëpunuar me BQK-në dhe me disa nga institucionet financiare kredidhënëse dhe kompanitë e sigurimeve. Si rezultat i kësaj, në sektorin e bujqësisë prej kur ka filluar edhe zyrtarisht projekti e deri më tani, kreditimi për sektorin e bujqësisë nga bankat ka shënuar rritje për 22.8 milionë euro apo 50.7% ku gjithsej portfolio

kreditore ka arritur në 67.9 milionë euro, kurse nga institucionet mikrofinanciare ka shënuar rritje për 37.1 milionë euro, ku gjithsej portfolio kreditore ka arritur në 54.2 milionë euro.

Megjithatë, edhe pse kreditimi në sektorin e bujqësisë në Kosovë është rritur, ai përbën vetëm 2.4% të gjithsej kredive të lëshuara apo 1.4% të Produktit të Brendshëm Bruto të vendit (krahasuar me pjesëmarrjen e bujqësisë në Produktit të Brendshëm Bruto me afër 8%), dhe me një normë të kredive joperformuese prej 3.8%, ende mbetet hapësirë për financim me kushte sa më të favorshme. Në anën tjetër, produktet bujqësore të mbuluara me sigurim përkundër përpjekjeve në këtë sektor vazhdojnë të mbeten në nivele të ulëta, ku shuma e siguruar është totalisht josignifikante. Megjithatë, në kuptim të infrastrukturës ligjore dhe kapaciteteve teknike është shënuar një progres, që shërben si bazë e mirë për të ardhmen.

Ne inkurajojmë institucionet kredidhënëse që të rritin kreditimin në sektorin e bujqësisë me kushte sa më të përballueshme dhe kompanitë e sigurimeve të rritin produktet vullnetare dhe mbulimet sidomos në sektorin e bujqësisë, ndërsa rekomandojmë Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që me rastin e hartimit të politikave të tilla të mundësojë që sigurimet bujqësore të jenë parakushte për fermerët kur përfitojnë grante dhe subvencionime, që të sigurohet qëndrueshmëria e investimeve, rendimenteve dhe sektorit në tërësi.

Pra, lidhur me sigurimet bujqësore, BQK duke u bazuar në fushëveprimin e saj dhe si partner zbatues në këtë projekt ka kontribuar në licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve dhe produkteve të kompanive të sigurimeve, të cilat kanë shprehur interesimin për të zgjeruar veprimtarinë e tyre për mbulimin e rreziqeve që lidhen me sektorin e bujqësisë.

Siguruesit fillimisht kanë ndërtuar kapacitetet e tyre përmes trajnimeve të stafit për zhvillimin e produkteve, marrjen në sigurim, matjen e rreziqeve përmes aktuarëve dhe ofrimin e këtyre produkteve për klientët që merren me sektorin e bujqësisë.

Ky projekt duhej të kishte rëndësi të veçantë edhe për faktin se do të mundësonte që klientët në sektorin e bujqësisë të kenë kushte më të favorshme përmes financimit nga bankat dhe institucionet kredidhënëse, rritnin konkurrencën, qëndrueshmërinë dhe pavarësinë e zhvillimit pa u bërë barrë e ndihmave shtetërore për mbulimin e humbjeve që lidhen me ngjarjet klimatike sikurse janë ngricat, breshëri, thatësira apo reshjet e tepruara klimatike.

Prandaj, megjithëqë baza ligjore dhe rregulltive si dhe kapacitetet fillestare janë ndërtuar, përkundër angazhimit, rezultatet në terren ende lënë shume për të dëshiruar, dhe kërkojnë rishikim serioz, prandaj ndaj duhet parë mundësitë që më tutje të avancohen këto skema me forma me inovative dhe gjithëpërfshirëse, si parakusht për rritje me tutje të këtij sektori dhe kontributit në ekonominë reale.

Me këtë rast, falënderoj Korporatën Financiare Ndërkombëtare për mbështetjen e vazhdueshme të dhënë ndaj institucioneve publike, bizneseve dhe institucioneve financiare që operojnë në Kosovë si dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për kontributin në këtë projekt dhe gatishmërinë për të avancuar edhe më tutje këtë sektor të një rëndësie vitale për ekonominë e vendit.

Jemi dëshmitarë të kohës se, rreziqet klimatike dhe të ambientit janë bërë problem i këtij shekulli ku qeveritë, rregullatorët, bizneset dhe individët janë duke ndërmarrë veprimet e nevojshme në përgjigje të kësaj çështje kritike. Prandaj, BQK ka adresuar këtë çështje përmes Draft-strategjisë për Ndryshimet Klimatike dhe të Ambientit dhe njëkohësisht përmes Planit Strategjik të BQK-

së për periudhën 2024-2028, krahas strategjisë kombëtare në nivel të vendit për adresimin e ndryshimeve klimatike dhe të ambientit.

Si përfundim, mund të themi se ekziston potencial i madh për mbështetje në këtë sektor edhe nga industria financiare përmes formave të ndryshme, sikurse të kreditimit ashtu edhe të sigurimit të produkteve në funksion të zbutjes së rreziqeve dhe rritjes së qëndrueshmërisë. Mbrojtja financiare, qasja në shërbime financiare, qëndrueshmëria e përgjithshme e këtij sektori dhe rritja e perspektivës për zhvillimin ekonomik në përgjithësi, mbetet përkushtim dhe prioritet i BQK-së.

Ju uroj punime të suksesshme në panelet në vijim dhe ju faleminderit!